



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 7601 Prot.
7

Patos më 09.04.2024.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 29.03.2024

I mbajtur sot më datë 29.03.2024 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë :

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Albiona Lamaj
2. Armand Ahmetaj
3. Erald Çepele
4. Ertilla Myrtaj
5. Renaldo Shpata
6. Vjollca Kasaj
7. Smerald Hazizaj
8. Elmira Rama
9. Lori Musaj
10. Suela Hoxhaj
11. Gani Ahmetaj
12. Shezair Sinanaj
13. Artan Velçani
14. Klarida Semanjaku

Takimi hapet nga Kryetari i Këshillit Z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përshëndetje të gjithëve!

Përpara se të filloj me leximin e rendit të ditës ju bej me dije se rendi i ditës është hartuar konform rregullores dhe ligjit, pra është vepruar ligjërisht nga kryesia dhe komisionet në datat e përcaktuara. Pjesëmarrja është e rregullt, në mbledhje janë të pranishëm 14(katërbëdhjetë) këshilltarë.

Nisim me leximin e rendit të ditës.

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 29.02.2024.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 29.02.2024.
- 4- Projekt-vendim “Për dhënie e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Shkurt 2024”.
- 5- Projekt-vendim “Për dhënie e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Shkurt 2024”.

- 6- Projekt-vendim "Për miratimin e Programit të Transparencës".
- 7- Projekt-vendim "Për miratim të Planit të masave për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri".
- 8- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës financiare në rast fatkeqësie të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë dhe humbjen e jetës së z. Sabri Serdari në fshatin Verbas, Njësia Administrative Zharrëz.
- 9- Mbi miratimin e tavaneve përgatitor të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027.
- 10- Projekt-vendim "Për miratimin e Raportit të Transparencës për procesin e Vendimarrjes së Këshillit të Bashkisë për vitin 2023".
- 11- Projekt-vendim "Për miratimin e Raportit të Vendimarrjes së Këshillit të Bashkisë për vitin 2023".
- 12- Informacion mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të inventarit për vitin 2023 (Agjencia e Shërbimeve Publike).
- 13- Për një ndryshim në VKB nr. 41 datë 27.07.2023 i ndryshuar "Për rishqyrtimin , miratimin dhe përbërjen e kryesisë së komisioneve të përhershme".

Armand Ahmetaj- Kush është dakord me rendin e ditës?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba



Smerod Haxhiu

Lori Musaj

Shqipëri
Lidhja e Shqipërisë

KRYETARI
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 769 / Prot.
8

Patos më 09.04.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.03.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 29.02.2024

Armand Ahmetaj- Nëse ka ndonjë diskutim, pyetje apo sygjërim për korrigjim procesverbali?

Nëse s'ka pyetje ose sygjërimë në bazë të nenit 77 të rregullores e konsiderojmë të miratuar unanimisht procesverbalin e mbledhjes së kaluar .

SEKRETARI

Refaela Xeba

Smerald Hazred
Lori MUSAJ

Armand Ahmetaj
Refaela Xeba

KRYETARI

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 769/9 Prot.

Patos më, 04 04.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.03.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 29.02.2024

Armand Ahmetaj – Të lutem Refaela!

Refaela Xeba, Përhëndetje të gjithëve! Në mbledhjen e datës 29.02.2024 janë marrë gjithsej 10 vendime.

Vendimet janë zbardhur në afat ashtu siç e përcakton ligji dhe rregullorja dhe janë përcjell drejtorisë përkatëse për ekzekutim.

Nga këto 10 vendime vendimi 11 dhe 12 ishte me karakter normativ, të cilët i janë përcjell prefekturës për verifikim dhe na ka ardhur përgjigja se vendimet janë në përputhje me ligjin.

Gjithashtu më lejoni t'ju informoj se nga ana e prefekturës kemi pasur një kontroll në vend në datën 06.03.2024, ku objekti i kontrollit ishte verifikimi i akteve normative të organit përfaqësues dhe organit ekzekutiv të Bashkisë Patos, për periudhën dhjetor 2023, janar-shkurt 2024 si dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Prefekti i Qarkut Fier në përfundim të verifikimit në vend të zhvilluar në muajin dhjetor 2023.

Nga kontrolli i ushtruar përfundimet janë si më poshtë vijon:

Nuk ka akte normative të Këshillit Bashkiak të padepozituara për verifikim tek Prefekti i Qarkut Fier.

Nuk ka akte normative të kthyera në kundërshtim me ligjin.

Nuk ka vendime të dërguara për pavlefshmëri në gjykatë.

Procesverbali i mbledhjeve mbahet në përputhje me ligjin.

Nuk ka rekomandime të lëna në kontrollin e kaluar.

Armand Ahmetaj - Po faleminderit! Atëherë vazhdojmë me pikën e radhës.

SEKRETARI

Refaela Xeba

Smeralda Hoxha

Lori Musaj

KRYETARI

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 720 Prot.

13

Patos më 04.04.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.03.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Shkurt 2024”.

Armand Ahmetaj – I lutem ekzekutivit, të dyja pikat për ndihmat kanë kaluar në komision dhe janë votuar unanimisht pro për tu kaluar në këshill.

Barie Goxhaj- Propozojmë të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor për muajin Shkurt 2024 gjithsej 21 familje me një fond prej 66,927 (gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e nëntëqind e njëzetë e shtatë) lekë.
Lista bashkëngjitur me emrat.

Armand Ahmetaj – Ka ndonjë pyetje? Diskutim?

Armand Ahmetaj -Atëherë kalojmë në votim për miratimin e pikës së katërt të rendit të ditës. Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin shkurt 2024”.

Kush është dakord?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI

Refaela Xeba

KRYETARI

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 721 Prot.
13

Patos më 09 04.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.03.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin shkurt 2024”.

Armand Ahmetaj – I lutem ekzekutivit

Barie Goxhaj-Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% për muajin Shkurt 2024 gjithsej 20 familje me një fond prej 91,299 (nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

Armand Ahmetaj – Keni ndonjë diskutim për këtë pikë para se të kalojmë në votim?

Atëherë kalojmë në votim nëse nuk kemi diçka tjetër për miratimin e pikës së pestë të rendit të shkurt 2024”.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI

Refaela Xeba

Lori Musaj Kap.

KRYETARI

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 674 Prot.
15

Patos më 04.04.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.03.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e Programit të Transparencës”.

Armand Ahmetaj – Ekzekutivi të relatoi

Ernesta Hamiti- Përshëndetje! Plani i Transparencës shërben për të vendosur informacion në shërbim të qytetarëve dhe është hartuar sipas një modeli standard, i cili është miratuar me urdhër të komisionerit për të drejtën e informimit në vitin 2018. Është miratuar fillimisht me vendimin e këshillit bashkiak nr. 83 në 20 dhjetor të vitit 2018. Sipas përcaktimit të ligjit programi transparencës duhet të rishikohet një herë në pesë vjet. Duke qënë se ka kaluar afati kohor e kemi kaluar përsëri për miratimin tuaj sipas urdhërit të komisionerit.

Albiona Lamaj- Ka ndonjë ndryshim apo është po i njejt?

Ernesta Hamiti- Jo është i njejt pasi modeli është standard me urdhër të komisionerit.

Keni ndonjë diskutim për këtë pikë para se të kalojmë në votim?

Atëherë kalojmë në votim nëse nuk kemi diçka tjetër për miratimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës, Projekt-vendim “Për miratimin e Programit të Transparencës”.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba

Smeralda Hoxha

Lori Musaj

Shpresa Arnesaj

KRYETARI
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 7381 Prot.
4

Patos më 04.04.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.03.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratim të Planit të masave për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri”.

Armand Ahmetaj- Të lutem ekzekutivit të relatoi.

Orges Gollosi - Përsëndetje të gjithëve! Drejtoria e Bujqësisë vjen me një projektvendim për miratimin e planit të masave për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri në mbështetje të nenit 30, pikat 4, 5 dhe 6 të ligjit nr. 57 datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, nenit 27, pika 5 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, VKM-së nr. 1080 datë 22.12.2010 “Për rregullat dhe parandalimin e shuarjes së zjarreve në pyjet dhe kullota”. Pas miratimit të planit të përgjithshëm ose diskutimeve që mund të kenë do të bëhet dhe zërtimi i këtij plani në planveprimin e drejtorisë. Plani i përgjithshëm i mbrojtjes nga pyjet përmban:

- Shkaqet kryesore të rënies së zjarrit në pyje.
- Klasifikimin e zjarreve në pyje.
- Faktorët që ndikojnë në rritjen e riskut për shfaqjen e zjarreve.
- Masat për parandalimin e zjarreve në pyje.
- Veprimet kryesore gjatë zbulimit
- Masat që do të zbatohen për parandalimin dhe menaxhimin
- Krijimin e strukturave në qendër dhe për çdo fshat (lagje), organizimin e vrojtimeve, sinjalizimeve nga pika më e lartë në lartësinë 545.8 m Cuka e Llasit, në Ekonominë Pyjore Drenie.
- Vendosjen e tabelave sensibilizuese “Mbroni Pyjet nga Zjarri”, në pikat kyçe dhe rrugë kalime të ndryshme;
- Pastrimi i brezit mbrojtës me Ekualiptë në Ekonominë Pyjore “Lumi Seman 2”.
- Organizimin e takimeve trajnuese me kryetarë të fshatrave dhe fermerë të Njësive Administrative të cilët disponojnë prona në kufi me sipërfaqet pyjore, punëtorët që do të punojnë për mirëmbajtjen e pyjeve si dhe skuadrave zjarrfikëse.

Nga hartimi dhe zbatimi i këtij plani synohet zvogëlimi i riskut në Ekonomitë Pyjore të bashkisë Patos.

Përsa më sipër për përmbushjen e detyrimit ligjor dhe zbutjen e riskut të zjarreve në pyje kërkojmë prej Këshillit Bashkiak miratimin e këtij plani masash. E theksoj që pas miratimit të planit ekzekutivi brenda dhjetë ditëve do të hartoi planveprimin, afatin kohor dhe personat përgjegjës të cilët do të kryejnë zbatimin e këtij planveprimi.

Erald Çepele- Shqetësimi im lidhet me pyllin e Drenies. Çfarë masash konkrete parashikoni ju pasi atje ka qënë dhe rreziku më i lartë ku ka pasur disa zjarre nga vitet e kaluara?

Kush janë masat konkrete që keni marrë ju lidhur me pyllin e Drenies? Pika e vrojtimit që është atje ka punonjës që meren me mirëmbajtjen dhe ruajtjen?

Infrastruktura rrugore që të mundësoi hyrjen e zjarrëfikseve e mundëson hyrjen e mjeteve?

Kryetari i Bashkisë- Në brendësi të pyllit normalisht nuk ka rrugë por ka akses. Masat që kemi marrë ne përveç shtimit të automjeteve aktualisht u shtua një fouristradë dhe nje autobus. Fouristrada në këtë rast është shumë e rëndësishme pasi për të arritur deri tek pylli i Drenies apo në vende të tjera që janë më të largëta me shtimin e mjeteve koha për të shkar është shumë e ultë. Besoj se në këtë pjesë jemi pak më mirë se çfarë kemi qënë por jo aq mirë sa duhet të jemi. Ndërsa për pjesën e rojes pylli i Drenies e ka një roje që merret me mirëmbajtjen dhe raportimin se çfarë ndodh në pyllin e Drenies.

Albiona Lamaj- Një sygjërim tek pjesa sensibilizuese, nuk e di a është e përmendur, ideja është që këto takime sensibilizuese të bëhen edhe nëpër shkolla mendoj unë, për faktorët e rënies së zjarrit, si duhet të mbrohemi.

Kryetari i Bashkisë- Te pjesa e shkollave është në programin mësimor por normalisht dhe një shtesë nga ana e bashkisë do jetë akoma më mirë.

Artan Velçani- Po bëhet fjalë për të miratuar një projektvendim për marrje plan masash. Bazuar dhe mbi nenet apo vendimet përkatëse. Sigurisht që meraku jonë si këshilltarë është që ky plan masash apo plan veprimi të jetë i detajuar sepse ajo pasuri është e rallë në bashkinë tonë me sa kam vlerësuar dhe duhet të këtë vërtet një plan masash nuk e di ndoshta të shoqëruar dhe me kosto financiare që të jemi të gatshëm ti miratojmë.

Kryetari i Bashkisë- Edhe te fondi i mbrojtjes civile ne kemi parashikuar një pjesë në mos gaboj 5% që do të jetë pikërisht për këtë gjë. Në vazhdimësi kjo ngelet për tu vlerësuar dhe për tu parë.

Armand Ahmetaj – Ka ndonjë pyetje? Diskutim?

Armand Ahmetaj -Atëherë kalojmë në votim për miratimin e pikës së shtatë të rendit të ditës. "Projekt-vendim "Për miratim të Planit të masave për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri".


Kush është dakord?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro. Është larguar Këshilltari Gani Ahmetaj.

SEKRETARI
Refaela Xeba



Smeralda Hoxha
Lori Musaj



KRYETARI
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 418/14 Prot.

Patos më 04.04.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.03.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës financiare në rast fatkeqësie të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë dhe humbjen e jetës së z. Sabri Serdari në fshatin Verbas, Njësia Administrative Zharrëz.

Ekzekutivi Relaton materialin e paraqitur me shkrim.

Arben Shpërdheja- Përshëndetje të gjithëve! Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës financiare në rast fatkeqësie të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë dhe humbjen e jetës së z. Sabri Serdari në fshatin Verbas, Njësia Administrative Zharrëz.

1. Të miratohët në masën e ndihmës financiare prej 500,000 (pesëqind mijë) lekë në rastin e humbjes së jetës të anëtarëve të familjes.
2. Vlera e kësaj ndihme do të mbulohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile 2024.
3. Shfuqëzimin e V.K.B-së nr. 52, datë 20.07.2022 “Për miratimin e ndihmës në rast fatkeqësie të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë dhe humbjen e jetës së z. Sabri Serdari në fshatin Verbas, Njësia Administrative Zharrëz”.

Nisur nga kërkesa e përsëritur, me nr. 418 prot., dt. 12.02.2024 e z. Alburant Serdari ku në kërkesë shprehet për ndihmë financiare, pasi si pasojë e zjarrit të rënë në banesë babai i tij ka ndërruar jetë. Kjo e vërtetuar me skedën e vdekjes dt. 27.04.2022. Z. Alburant Serdari ka paraqitur kërkesën me nr.1155 prot., datë 10.05.2022, për verifikimin e dëmeve të shkaktuara në banesë dhe për ndihmë për rehabilitimin e saj. Për verifikimin e kërkesës së qytetarit është ngritur komisioni me urdhërin nr. 80, datë 06.05.2022. Komisioni ka shkuar në terren dhe ka mbajtur procesverbal më datë 10.05.2022, mbi dëmet e shkaktuara nga kjo fatkeqësi. Në bazë të pikës 2 dhe shkronjës a) të pikës 3 të kapitullit III të V.K.M-së nr. 329, datë 16.5.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” i ndryshuar, përcaktohet “Dokumentacioni i nevojshëm për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare”: a) Procesverbali i konstatimit të gjendjes; b) Vendim i këshillit të komunës ose i bashkisë; c) Preventivat e dëmeve nga ana ndërtimore në objektet e banimit, si dhe dëmet në orendi, mobilie dhe pajisje elektroshtëpiake; ç) Çertifikata familjare në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë; d) Çertifikata e vdekjes së pjestarit të familjes, kur ka raste të tilla, shoqëruar me vërtetimin e komisionit mjekoligjor, sipas rasti; dh) Akt-ekspertiza nga PMNZSH-ja, në raste zjarri dhe vërtetimi nga Policia e Shtetit ose prokuroria e rrethit, në raste eksplozivi; e) Studimi gjeologjik i hartuar nga Shërbimi

Gjeologjik Shqiptar ose subjekte të licensuara nëse është rrëshqitje toke; ë) Konfirmimi i vendimit të njësisë së qeverisjes vendore për bazueshmërinë ligjore nga ana e institucionit të Prefektit të qarkut; f) Shkresa nga njësitë e qeverisjes vendore dhe këshilli i qarkut, ku të shprehet masa e ndihmës së dhënë për familjen e dëmtuar, në rast se ka, ose pamundësia financiare për ta ndihmuar, për mungesë fondesh.

Pika 3. Përcaktimi i ndihmës financiare. a) Masa e ndihmës financiare që Këshilli i Ministrave ose Ministria e Brendshme akordon në rastin e humbjes së jetës së anëtarëve të familjes, si pasojë e fatkeqësisë, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për çdo person të vdekur.

Në mbështetje të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, V.K.M-së nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, i ndryshuar, V.K.M-së nr. 414, dt. 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, pika 3.1 shkronja a) akordimin e ndihmës financiare për familjet, banesat e të cilave janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera sipas kriterëve specifike të përcaktuara në aktet nënligjore që rregullojnë ligjin nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, neni 41, “E drejta e kompesimit”, pika 2) dëmet përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësia, nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile, për këto arsye i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

Të miratojë masën e ndihmës financiare **prej 500,000 (pesëqind mijë) lekë** në rastin e humbjes së jetës të anëtarëve të familjes.

Me kërkesën për ndihmë financiare të Bashkisë Patos me nr. 2109 prot., datë 31.08.2022 drejtuar Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Brendshme.

Me shkresën nr. 4961/1 prot., datë 20.09.2022 kërkesë për ndihmë financiare të Bashkisë Patos, Sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrisë udhëzon Bashkinë Patos për t’ia përcjellë praktikën dokumentare Ministrisë së Mbrojtjes.

Me shkresën nr. 8974/1 prot., datë 13.09.2022 të Ministrisë së Brendshme, kërkesën për ndihmë financiare të Bashkisë Patos me nr. 2109 prot., datë 31.08.2022 e ka adresuar në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile me shkresën nr. 1504/2 prot., datë 22.09.2022 kërkesë për ndihmë financiare në rast humbje jete, drejtuar Bashkisë Patos, për dijeni Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave për Çështjet Vendore dhe Prefekturat, sqaron se:

Bazuar në ligjin nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile” përkatësisht pikës 1, të nenit 65, “Buxheti i Bashkive”, neni 41, “E drejta e kompesimit” V.K.M-së nr. 414 dt. 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në referencë edhe në rastin e mësipërm, trajtimi i situatës së sipërpërmendur ngelet nën administrimin e plotë të institucionit tuaj, i cili mbështetet në parashikimin minimal prej 4% të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të siguruar nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.

Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile me shkresën nr. 1636/2 prot., datë 11.10.2022 drejtuar Bashkisë Patos, për dijeni Kryeministrisë, sqaron Bashkinë Patos për vazhdimësinë e procedurës ligjore bazuar në ligjin nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile” neni 41, “E drejta e kompesimit”, V.K.M-së nr. 414 dt. 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.

Këshilli i Bashkisë bazuar në projektvendimin me nr. 51, datë 15.07.2022, me nr. 1155/3 prot., datë 15/07/2022, relacionin me nr. 1155/4 prot., datë 15.07.2022, "Për miratimin e ndihmës në raste fatkeqësie të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë dhe humbjen e jetës së z. Sabri Serdari në fshatin Verbas, Njësia Administrative Zharrëz", ka marrë Vendimin nr. 52, datë 20.07.2022, me nr. 1155/4 prot., datë 26.07.2022.

Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 871/1 prot., datë 19.08.2022, "Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve të Këshillit Bashkiak Patos me nr. 52, datë 20.07.2022", shprehet:

Ky vendim i miratuar nga Këshilli Bashkiak Patos, bazuar në nenin 3, pika 2, të ligjit 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative", nuk përbën akt me karakter normativ. Në këtë rast, Prefekti të Qarkut Fier detyrimi për të verifikuar ligjshmërinë, i lind nga neni 8, shkronja "j", e ligjit nr. 107/2016, "Për Prefektin e Qarkut", në të cilën parashikohet se Prefekti i Qarkut ushtron dhe detyra të tjera të ngarkuara me akte ligjore ose nënligjore. Konkretisht kjo detyrë parashikohet në kreun III, pikën 1, shkronjën "f", të VKM-së me nr. 329, datë 16.5.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".

Aktualisht ligji bazë që rregullon dhënien e ndihmave financiare në rast fatkeqësie natyrore ose fatkeqësie tjetër të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, është ligji nr. 45/2019, "Për Mbrojtjen Civile". Sipas tij aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 8756, datë 26.03.2001, "Për Emergjencat Civile", (tashmë i shfuqizuar), zbatohen për aq kohë sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj. Nga ana juaj nëpërmjet vendimit nr. 52, rezulton të jetë miratuar dhënia e ndihmës financiare prej 500,000 mijë lekë nga Këshilli i Ministrave ose Ministria e Brendshme, me rastin e humbjes së jetës të anëtarit të familjes, z. Sabri Serdari. Pra Këshilli Bashkiak Patos ka miratuar ndihmë financiare me fonde të Këshillit të Ministrave ose Ministrisë së Brendshme, kompetencë kjo e cila nuk i takon Këshillit Bashkiak Patos.

Nga procesverbali i mbledhjes rezulton se Bashkia Patos nuk ka dhënë ndihmë financiare pasi familja ka qenë qiramarrëse dhe jo pronarë të shtëpisë. Në rastin tuaj ndihma nuk është akorduar dhe nuk keni sqaruar pse Bashkia Patos është në pamundësi financiare për të akorduar ndihmën financiare nga fondet e veta.

Në VKM-në me nr. 329, datë 16.5.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", parashikohet si kompetencë e këshillit të bashkisë marrja e vendimit për dhënien e ndihmës financiare, (pas shqyrtimit të procesverbalit të konstatimit të gjendjes dhe të dokumentacionit të vlerësimit të dëmeve) me përjashtim të rastit kur bashkia do të ishte në pamundësi financiare për të ndihmuar, fakt ky i cili do duhej të shprehej me shkresë. Në pikën 3, të kreut III, të VKM-së të sipërcituar parashikohet masa e ndihmës financiare që Këshilli i Ministrave ose Ministria e Brendshme, akordon në rastin e humbjes së jetës së anëtarëve të familjes, si pasojë e fatkeqësisë, që është 500,000 mijë lekë për çdo person që ka humbur jetën. Si rrjedhojë vendimi për të akorduar ndihmën financiare i takon institucionit nga i cili do të merren fondet.

Në këto kushte, bazuar në nenin 16, shkronja "b/i", të ligjit nr. 107/2016, "Për Prefektin e Qarkut", vendimi ju kthehet jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke përfshirë dhe ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54, ligjit nr. 45/2019, "Për Mbrojtjen Civile", dhe V.K.M-së nr. 329, datë 16.5.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".

Në këto kushte bazuar në ligjin nr. 44/2015, "Kodi i procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", neni 113, pika 3, "Anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë": Kërkojmë nga ana e këshillit bashkiak anulimin e vendimit nr. 52, datë 20.07.2022, me nr. 1155/5, datë 26.07.2022, "Për miratimin e ndihmës në raste fatkeqësie të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë dhe humbjen e jetës së z. Sabri Serdari në fshatin Verbas, Njësia Administrative Zharrëz".

Erald Çepele- Jam shumë i qartë pasi e kam ndjekur vet si rast, është një situatë e dhimbshme kështu që i ftoj të gjithë këshilltarët që ne të korrigjojmë vendimin nr. 52 i cili është nul dhe ta miratojmë ashtu si e ka paraqitur ekzekutivi.

Artan Velçani- Unë jam i paqartë. Vendimi që paskemi marrë nr. 52 në 2022 mesa kuptova unë këshilli i bashkisë ka dhënë ndihmë por jo nga fondet e tij por nga fondet e Ministrisë, nga ajo që dëgjova unë po nga Beni në një referim të tij lejohet nga ligji që nga fondet e kushtëzuara 4% të përdoret. Pavarishtë gjerave unë jam dakord ti vijmë në ndihmë njerëzve në nevojë por jam i paqartë dhe më duhet ndihma e një jurisi në këtë rast dmth ne kemi marrë një vendim, ligji e parashikon po që vendimi për atë 4% e e lejon dhe Prefektura na e kthen.

Erald Çepele- Artan vendimi nr. 52 i këshillit bashkiak të kaluar është thënë që kompesimi të bëhet nga Këshilli i Ministrave ose Ministria e Brendshme dhe Këshilli nuk mund të marri vendim për një institucion tjetër, të urdhërojë një institucion tjetër, kështu që ky vendim është nul. Ne po marim vendim sot dhe fondet do merren nga fondet e emergjences ose nga fondet e veta. Nuk mund të marim vendim për institucione të veta.

Këshilltari Novrus Toska është prezent në sallë .

Armand Ahmetaj – Atëherë kalojmë në votim për miratimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës financiare në rast fatkeqësie të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë dhe humbjen e jetës së z. Sabri Serdari në fshatin Verbas, Njësia Administrative Zharrëz.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba



Smerald Hoxha
Loni MUSAJ

KRYETARI
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 729 Prot.

16

Patos më 04.04.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.03.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “ Mbi miratimin e tavanëve përgatitor të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027.

Ekzekutivi Relaton

Mimoza Shtëmbari- Drejtore e Financës dhe Shërbimit Social.

Përshendetje të gjithëve!

Në zbatim të ligjit 68”Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit nr. 23, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të Vetëqeverisjes Vendore”, udhëzimit plotësues të vitit vjetor nr. 03 po u paraqesim projektvendimin mbi miratimin e tavanëve përgatitor të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027.

Siç dhe ju keni filluar me miratimin e fazës së hartimit të buxhetit afatmesëm me miratimin e të ardhurave i cili është miratuar në muajin shkurt fillojnë dhe ndiqen fazat sipas kalendarit të miratuar në dhjetor nga këshilli për përgatitjen dhe hartimin e kërkesave buxhetore për buxhetin afatmesëm 2025-2027 si dhe për buxhetin vjetor që është viti i parë i PBA-së. Në relacion janë shprehur qartë objektivat për çdo program, tavanet si institucion dhe tavanet për çdo program. Në relacion është përcaktuar pesha specifike e çdo lloj burimi financiar si dhe pesha specifike e çdo shpenzimi ndaj gjithë planit buxhetor për çdo vit të PBA-së. Në materialin e paraqitur ju kemi paraqitur tavanet e shpërndara në pesëmbëdhjetë programe me nga njëzetë që parashikon instrumenti financiar të cilat janë me nje rritje prej 1.4, 1.5% duke ju referuar vlerës së buxhetit 2024 ndersa të ardhurat, burimet janë rritur 5% për 2025 në krahasim me vitin 2024, 2% për vitet 2026 ,2027. Në vija të përgjithshme treguesët janë të detajuar sipas relacinut por më të qarta janë në tabelat që përcaktojnë të ardhurat dhe tavanet për çdo program.

Erald Çepele- Kisha një pyetje lidhur me transfertat. Nëse do të kemi një rritje të pagave nga qeveria patjetër që do të shoqërohet me rritje të fondit të transfertatave specifike apo të kushtëzuara apo mund të rishikohet? Si e keni menduar këtë pjesë?

Mimoza Shtëmbari- Drejtore e Financës dhe Shërbimit Social – Që nga fillimi ne themi përgatitor dhe jo përfundimtar. Gjatë ecurisë pas kalendarit që ju keni miratuar ne do të thithim të gjithë prioritetet dhe kërkesat duke udhëhequr dëgjesat edhe nga këshilli dhe do të hartojmë kërkesat buxhetore. Në muajin qershor këto dalim në nje dokument të parë përgatitor të buxhetit. Në rast se gjatë kesaj faze deri në datën 1 qershor ne hartojmë buxhetin nese kemi një ndryshim të transfertave ne do të pasqyrojmë ndryshimin e tavanëve ku do vijnë përsëri për ndryshim të tavanëve . Kjo është ecuria.

Armand Ahmetaj –Para se ta kalojmë në votim dua t’ju informoj se edhe kjo pikë ka kaluar në komisionin e Ekonomisë dhe e ka votuar unanimitisht pro.

Atëherë kalojmë në votim.

Kush është dakord për Projekt-vendim “Mbi miratimin e tavaneve përgatitor të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027.


Armand Ahmetaj - Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba



S. Mevlud Hoti
Lori Musaj

KRYETARI
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 746 Prot.
2

Patos më 04.04.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.03.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e Raportit të Transparencës për procesin e Vendimarrjes së Këshillit të Bashkisë për vitin 2023”.

Armand Ahmetaj- Është Një detyrim që rrjedh nga ligji 139/2015 dhe rregullores. Ka të bëjë me veprimtarinë e këshillit gjatë kësaj periudhe. Autorizojë sekretaren e këshillit të lexoj materialin.

Refaela Xeba -Mbështetur në pikën 3 të nenit 15 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 4 neni 120, *Vlerësimi i Performancës dhe Llogaridhënia e Këshillit dhe Sekretariatit*” i rregullores “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Bashkisë Patos”, Ligji nr. 146/2014 “Për të drejtën e Konsultimit Publik” neni 11 i VKB nr. 1 datë 27.01.2022 “Rregullorja për Konsultimet Publike të Këshillit Bashkiak”, po ju prezantojmë Raportin e Transparencës së Vendimarrjes së Këshillit Bashkiak për vitin 2023.

Ky Raport përmban informacion për:

Numrin e akteve të miratuara nga ograni publik përkatës gjatë vitit 2023.

Numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palet e interesuara gjatë seancave të dëgjësive publike:

Numrin e rekomandimeve të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimarrjes.

Numrin e takimeve publike të organizuara.

Referuar sa më sipër Këshilli i Bashkisë gjatë vitit 2023 ka marrë 85 (tetëdhjetë e pesë) vendime në total.

Nga këto vendime në total për 7 vendime janë realizuar konsultime publike.

Në lidhje me tematikat e tyre:

Vendime për çështje financiare /tatime/buxheti/ nivel pagash 18

Vendime për çështje projktesh infrastrukturore 1

Vendime për çështje urbane dhe pronash 4

Vendime për çështje sociale, ndihmë ekonomike 33

Vendime për çështje arsimit, bursa 2

Vendime për çështje të ndryshme 27

Për secilin projektvendim që ka kërkuar konsultim publik është përgatitur Njoftimi dhe Kalendari i konsultimeve i cili është publikuar në rrjetet sociale të Këshillit dhe në faqen zyrtare të Bashkisë. Njoftimi dhe kalendari kanë pasur në përmbajtje elementët e përcaktuar nga ligji si data, ora, grupet e interesit dhe përshkrimi i projektaktit.

Në konsultimet publike kanë marrë pjesë anëtarët e këshillit sipas tematikave të konsultimeve publike. Procesverbalet janë mbajtur nga koordinatori i konsultimeve publike. Konsultimet publike janë realizuar në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë.

Pas mbajtjes së konsultimit publik procesverbali është protokolluar, një kopjë gjendet në arkiven e bashkisë dhe një kopje është postuar në faqen zyrtare të këshillit të bashkisë. Sekretari i bashkisë i ka përcjell rekomandimet e marra drejtorisë përkatëse. Po ashtu edhe për dëgjësia publike përveç takimeve në terren është përdorur varianti online, ku në dispozicion të qytetarëve është vendosur emaili i sekretarisë së këshillit ku ata mund të dërgonin komentet e tyre. Nga kontrolli emailit nuk rezulton ndonjë reagim apo propozim nga ana e qytetarëve.

Numri i përgjithshëm i rekomandimeve të marra nga palët e interesuara:

Gjatë procesit konsultativ u regjistruan gjithsej 21 rekomandime konkrete.

Numri i rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara:

Nga 26 rekomandime u mbajtën parashysh 23 dhe 3 u kthyen me motivim të arsyetuar nga zyrtarët publik të cilët u angazhuan në organizimin dhe drejtimin e dëgjësive publike.

Regjistri i Konsultimeve Publike gjendet i publikuar online në faqen e Këshillit të Bashkisë. Për secilin konsultim publik pas përfundimit të tij publikohet një përmbledhje e aktivitetit së bashku me fotot përkatëse.

Armand Ahmetaj – Keni ndonjë pyetje? Meqë s'keni po e kaloj në votim Projekt-vendim “Për miratimin e Raportit të Transparencës për procesin e Vendimarrjes së Këshillit të Bashkisë për vitin 2023”.

Kush është dakord?


Armand Ahmetaj - Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba



Lori Musaj Maj.

KRYETARI
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 748 Prot.
12

Patos më 04.04.2004.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.03.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Projekt-vendim "Për miratimin e Raportit të Vendimarrjes së Këshillit të Bashkisë për vitin 2023".

Armand Ahmetaj – Po Refaela

Numri total i mbledhjeve të miratuara gjatë vitit 2023 është 85. Nga këto vendime vetëm 15 kanë qënë me karakter normativ dhe 2 vendime nuk kanë qënë me karakter normativ por ligjshmëria e tyre është verifikuar nga Prefekti i Qakut për shkak të parashikimit ligjor, ndërsa pjesa tjetër ka qënë me karakter individual dhe kolektiv. Vendimet me karakter normativ i janë dërguar Prefekturës së Qarkut Fier për konfirmim ligjor për të cilat është konfirmuar ligjshmëria ndërsa për një vendim ka ardhur përgjigja se nuk është në përputhje me ligjin, konkretisht vendimi nr. 20 datë 27.03.2023.

Mbledhje të zhvilluara online nuk ka.

Numri i mbledhjeve të zhvilluara në sallë është 14 të cilat kanë qënë të hapura për publikun. Nga mbledhjet e zhvilluara 12 kanë qënë mbledhje të radhës dhe dy jashtë radhe me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë. Një pjesë të mbledhjeve janë zhvilluar live në faqen e facebook të Këshillit ndërsa pjesa tjetër është e regjistruar me video-audio. Njoftimi i mbledhjeve dhe publikimi është bërë sipas kriterëve që përcakton ligji.

Nuk ka projektvendimeve të kthyera nga këshilli gjatë vitit 2023.

Zbatimi i vendimeve nga administrata. Pas zbardhjes së vendimeve ato i kalojnë ekzekutivit për zbatim si dhe në çdo mbledhje pasardhëse është raportuar gjithmonë në lidhje me zbatueshmerinë e tyre. Në pikën e tretë të rendit të ditës është dhënë informacion mbi vendimet e marra nga këshilli, konfirmimet e ligjshmërisë nga prefektura si dhe zbatimi i tyre në administratë.

Vetëm një vendim është kthyer nga Prefektura ku ka ardhur përgjigja se nuk është në përputhje me ligjin.

Të gjitha vendimet pas zbardhjes së tyre janë dërguar platformës Vendime.al e cila është e ndërlidhur dhe me ëeb-in e këshillit.

Armand Ahmetaj - Kush është dakord për Projekt-vendim "Për miratimin e Raportit të Vendimarrjes së Këshillit të Bashkisë për vitin 2023".

Armand Ahmetaj - Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba

Smerold Hoxha

Lori Musaj

KRYETARI
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 439 Prot.
2

Patos më 04.04.2004.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.03.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dymbëdhjetë të rendit të ditës.

Informacion mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të inventarit për vitin 2023 (Agjencia e Shërbimeve Publike).

Afërdita Muço- Relaton materialin e paraqitur me shkrim.

Erald Çepele- Jemi dakord lidhur me këtë pjesë- Sygjerimi im lidhur me pjesën e pajisjeve, nuk e di këto janë jashtë përdorimit dhe do çohen për skarp apo? Doja të sygjeroja që këto korrëse bari mund të mbahen aty dhe ndoshta mund të hyjnë në punë.

Afërdita Muço- I kemi në ambjentet e ndërrmarjes, dhe ato pjesët që na duhen bëjmë riparime.

Armand Ahmetaj - Kemi pyetje tjetër? Nuk kemi votim sepse është informacion.

SEKRETARI
Refaela Xeba

Lori Musaj

KRYETARI
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 684 / Prot.
3

Patos më 04.04.2004.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.03.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së trembëdhjetë të rendit të ditës.

Projektvendim “Për një ndryshim në VKB nr. 41 datë 27.07.2023 i ndryshuar “Për rishqyrtimin , miratimin dhe përbërjen e kryesisë së komisioneve të përhershme”.

Armand Ahmetaj – Dua tju qartësoj shkurtimisht se rastet të tilla janë të rralla. Një këshilltarë konkretisht z. Gani Ahmetaj i ka paraqitur këshillit dorëheqjen për tu dorëhequr nga pozicioni i kryetari të komisionit të ligjeve. Ndodhur në këto kushtë kryesia ka kaluar në konsultime me kryetarët e grupeve, kemi ezaurim të nenit 31 për krijimin e komisioneve të përhershëm të këshillit. Nuk kemi ndryshim në përbërje apo në numër thjesht kemi një ndryshim në riorganizimin e komisionit. Pra për pamundësi që ky anëtar i këshillit të ndjek rregullisht ose të drejtoi mbledhjet e komisionit i ka kërkuar komisionit që të qëndroi në pozicionin e anëtarit. Mbas kësaj kryesia ka njoftuar komisionin i cili është mbledhur dhe ka miratuar me pesë vota kërkesën. Përbërja e komisionit të mëparshëm ka qënë

- | | |
|-----------------------|------------|
| 1. Gani Ahmetaj | Kryetar |
| 2. Klaudio alisinanaj | Zv/kryetar |
| 3. Artan Velçani | Anëtar |
| 4. Smerald Hazizaj | Anëtar |
| 5. Ertila Myrtaj | Anëtar |

Komisioni ka votuar me votimin e tij që kryetar të zgjidhet Klaudio Alisinanaj ,
Smerald Hazizaj Zv/kryetar
Artan Velçani Anëtar
Gani Ahmetaj Anëtar
Ertila Myrtaj Anëtar

Armand Ahmetaj - Kemi pyetje tjetër ? Kush është dakord për projekt-vendimin “Për ndryshim të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 74 datë 30.11.2023

Armand Ahmetaj – Asnje kundër, abstenim ska , miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba

KRYETARI

Armand Ahmetaj